



EmpowerMed

Situata aktuale në Bashkinë Vlorë

*Vlerësim nga perspektiva e
varfërisë energjitike, gjinisë
dhe ndikimit në shëndet*

Paketa 1 - Mobilizimi i aktorëve vendorë
Version 4, Shkurt 2020





Ky projekt financohet nga Programi i Kërkimit dhe Inovacionit Horizon 2020 të Bashkimit Evropian, kontrata Nr. 847052.



Ky dokument është hartuar si pjesë e projektit EmpowerMed - *Fuqizimi i grave për të vepruar ndaj varfërisë energjitike në Mesdhe.*



Drejtuesi i Paketës: Universiteti Autonom i Barcelonës (UAB)

Partneri përgjegjës: Milieukontakt Shqipëri (MiA)

Dokumenti D1.1

VERSION 4, 20 Shkurt 2020

Shënim: Riprodhimi i përmbajtjes ose pjesëve të tij lejohet vetëm me autorizim nga autorët dhe me citimin e burimit.





Përmbajtja:

1. Hyrje	6
2. Informacion i përgjithshëm	7
2.1 Profili i bashkisë	7
2.2 Papunësia	10
2.3 Punësimi	10
2.4 Sektorë të rëndësishëm të ekonomisë	11
2.5 Furnizimi me ujë	12
2.6 Furnizimi me energji	14
2.7 Ngrohja e banesave	14
3. Identifikimi i familjeve në varfëri energjitike	18
3.1 Familjet e cënuara	20
3.1.1 Familje në ndihmë ekonomike	21
3.2 Problemet specifike të zonës me varfëria energjitike	24
3.3 Tipet kryesore të varfërisë energjitike dhe grupet e synuara në zonën pilot	24
4. Vlerësimi i nevojave të familjeve të cënuara / përfituese të mundshëm	25
4.1 Gjinia	26
4.2 Shëndeti	26
5. Përqasja për të arritur familjet në nevojë dhe angazhimi i aktorëve të duhur	27
6. Informacione shtesë specifike për Rajonin e marrë në studim.	31
Referenca	35
Shtojca	36
1.1 Takime me aktorët vendorë	36
1.2 Gender equalite index Albania 2019	39
1.3 Të dhëna nga Censusi 2011, Instat për qarkun Vlorë	42



Lista e Figurave dhe Tabelave

Figura 1. Harta e Planit të Zhvillimit Bashkia Vlorë

Figura 2. Përlllogaritja e popullsisë së turizmit

Figura 3. Harta e përmbytjeve në zonën e Vjosës 2015-2018

Figura 4. Dëmet në banesa dhe toka nga përmbytjet

Figura 5. Punësimi sipas sektorëve

Figura 6. Paga mesatare bruto në Shqipëri, vitet 2015-2018

Figura 7. Infrastruktura e Energjisë në Vlorë

Figura 8. Sistemi i ngrohjes në Balkanin Perëndimor

Figura 9. Kufiri i varfërisë energjitike në Ballkanin Perëndimor

Figura 10. Konsumi i energjisë dhe humbjet në rrjet

Figura 11. Përdorimi i energjisë elektrike në sektorin familjar, 2013

Figura 12. Aspekete sociale nga pikëpamja gjinore

Figura 13. Kopje e mandat pagesës së Energjisë Elektrike nga një klient familjar

Figure 14. Qendra shëndetësore Novoselë

Figura 15. Tipet dhe vjetërsia e banesës

Figura 16. Izolimi i dyerve dhe dritareve

Figura 17. Tipi i izolimit

Figura 18. Vjetërsia e ndërtesës dhe izolimi

Figura 19. Banesa dhe tipi i xhamave

Figura 20. Problemet me mykun

Figura 21. Përdorimi i energjisë elektrike

Tabela 1. Demografia, Bashkia Vlore

Tabela 2. Papunësia në vite në Bashkinë Vlorë

Tabela 3. Punësimi në vite

Tabela 4. Sistemi i furnizimit me ujë, Qarku Vlorë

Tabela 5. LLoji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje, Qarku Vlorë

Tabela 6. Te dhëna për konsumin e energjisë elektrike për klientë familjarë

Tabela 7. Te dhëna për furnizimin me energji elektrike

Tabela 8. NJE familjare, pajisjet afatgjata dhe shërbimet dhe numri i personave në familje, Qarku Vlorë

Tabela 9. Familjet në NE dhe PAK sipas gjinisë zone rurale dhe urbane.



Executive Summary

The Pilot Site Report for Vlora Municipality is aiming to describe actual situation, specific aspects of the area focusing on identification of families on energy poverty, assessment of their needs, setting methods and approach to reach and engage the target group. Different documents, national reports and studies have been reviewed parallel to direct meetings with local authorities, agencies and focus group discussion with vulnerable groups.

Energy Poverty in Albania is not defined concept either monitored. There are no specific policies in place designed to alleviate energy poverty. As part of Energy Community since 2006, Albania is obliged to fulfil obligations deriving from the membership. But the Commissioner for Protection against Discrimination following requests, complaints made by citizens concluded that: *there is a lack of bylaws on the criteria and procedure for obtaining the status of the client in need and the manner of their treatment.*

The report confirms that there is the lack of data on persons suffering from energy poverty or related data to unemployment, level of well being, citizens suffering from diseases, gender mainstreaming, etc. Data gathered in local level shows that only 64% of the households are paying bills regularly and that the minimum monthly energy consumed per households (168 kWh) in Vlora is 23% lower than the minimum in national level. In order to compensate the lack of data at Vlora Municipality, in the assessment part there are references with national data and some extrapolation to local level. Missing data means no visibility; lack of visibility means lack of interest; lack of interest is followed by lack of action and lack of accountability. The client in need is not a well-defined entity / homogenous and is largely gender related. This is a very important dimension of the EmpowerMed project.

The project will target the following vulnerable groups: (i) the elderly, mostly women; (ii) single parent families, mainly single mothers, (iii) ethnic communities (Roma, Egyptian); (iv) unemployed and employed at risk of poverty, mainly women.

Specifically the main **way to identify and reach** vulnerable groups will be through:

- I. Establishing partnerships with vulnerable families and NGOs operating in the area.
- II. Workshops on health impact of energy poverty with participation of Health Units.
- III. Focus on problems related to structure of the buildings (humidity, mold, thermo isolation, heating, cooling, cooking, etc.) related to fulfilment of the basic needs.
- IV. Facilitating the life of the local community by design and implement small investments in dwellings that have multiple problems as electricity supply, humidity, etc.
- V. Promoting good investment practices (renovation/rehabilitation of public buildings) in order to ensure minimum living standards and access to electricity.
- VI. Conducting studies and research on energy auditors with involvement of Universities.
- VII. Involving roma community as volunteers during house visits and in small interventions.
- VIII. Lobbying at local level that in public buildings to address energy performance.
- IX. Improving social policies that help lower-income families to cope with energy poverty and eradicate informality.

1. Hyrje

Milieukontakt Shqipëri së bashku me 8 partnerë të tjerë nga Mesdheu ka startuar projektin EmpowerMed (Programi i Kërkimit dhe Inovacionit, Horizon 2020) që adreson sfidën e varfërisë energjitike, me fokus të vecantë në përfshirjen dhe fuqizimin e grave. Në vendet e Mesdheut, zonat bregdetare hasin një sërë sfidash në lidhje me varfërinë energjitike, natyrshëm lidhur me ngrohjen dhe ftohjen në banesa. Ndërtesat rrallë janë të izoluara, shpesh pa sistem ngrohje, ose jo efikas. Varfëria energjitike prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe familjet e drejtuara nga gratë. Projekti do të trajtojë specifikisht edhe ndikimin e varfërisë energjitike në shëndetin e njeriut.

Hapi i parë i projektit është mobilizimi dhe rrjetëzimi me aktorët lokal në zonën e Mesdheut (Vlorë – Shqipëri, Barcelonë – Spanjë, Marseille – Francë, Padova – Itali, Primorska – Slloveni, dhe Zadar – Kroaci), vlerësimi i situatës dhe kalimi i njohurive dhe eksperiencave thelbësore për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në zbatimin e masave praktike. Themeli i projektit janë zbatimi i masave praktike për të adresuar varfërinë energjitike, si qasje në komunitet, vizita në banesa, qasje të veçanta, mbështetje me investime të vogla dhe workshope për shëndetin. Efektshmëria dhe ndikimi i aktiviteteve të zbatuara do të vlerësohet dhe analizohet, dhe rezultatet e përfuara do të jenë baza e rekomandimeve politike që do të hartohen. Partnerët e projektit dhe aktorët vendor do të advokojnë për promovimin e politikave që adresojnë varfërinë energjitike. Në këtë kuadër Milieukontakt ka përpiluar një raport fillestar i mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit, takimet me institucionet vendore dhe agjencitë e ndryshme që veprojnë në bashki, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe intervistat me banorë të zonës.

Ky raport i situatës aktuale të Bashkisë Vlorë ka për synim të përshkruaj situatën lokale në zonën pilot duke u fokusuar në identifikimin e familjeve në varfëri energjetike, vlerësimin e nevojave të tyre, përcaktimin metodave të komunikimit për t'i arritur ato dhe angazhimin e aktorëve të duhur si dhe aspekteve specifike të zonës pilot.

KONCEPTI VARFËRI ENERGETIKE

Varfëri energjetike është situata në të cilën një familje nuk mundet të aksesojë shërbimet energjetike në shtëpi në një nivel të atillë që mund të përballojë nevojat e saj sociale dhe material (Bouzarovski dhe Petrova, 2015).

Në vendet e Evropës, varfëria energjetike i referohet në mënyrë të përgjithshme situatës ku individët nuk janë në gjendje të sigurojnë energjinë e nevojshme në banesë me një çmim të përballueshëm.

Koncepti në projekt analizon tre shtylla:

politikat e energjisë, politikat sociale e gjinore dhe ndikimi në shëndet.

2. Informacion i përgjithshëm

2.1 Profili i bashkisë

Me miratimin e Ligjit 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Bashkia Vlorë kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë.

Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra; në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Vlorës. Kjo zonë ka në përbërje dhe parkun detar-bregdetar Sazan-Karaburun, që është i vetmi i këtij lloji në vendin tonë.

Zona ka praninë e minorancave etnike, përkatësisht minorancës Greke në zonën e Nartës dhe asaj rome e egjiptiane në Novoselë e Shushicë. Tendencat demografike kanë qenë ato të një qyteti që ka pësuar si emigrimin edhe migrimin nga zonat rurale në ato urbane. Burimet kryesore ekonomike janë turizmi, bujqësia, blegtoria dhe industria. Si një qytet bregdetar, Vlorë është edhe një qendër e rëndësishme e peshkimit.

Sipas Census-it të vitit 2011 bashkia e re ka **104,827 banorë**, ndërsa në janar 2020 rezultojnë **202,751 banorë** (gra

101,332, burra 101,419) (Burimi: Bashkia Vlorë). Nga këto të dhëna kemi një shpërndarje pothuajse të barabartë burra-gra të popullsisë residente, gjë që tregon se flukset migratore tashmë janë stabilizuar duke eliminuar shpërndarjen jo të rregullt të popullsisë sipas gjinisë. Bashkia e Vlorës ka një sipërfaqe prej 616.85 km² me densitet 169.9 banorë/km² ndërsa sipas të dhënave të regjistrat civil, densiteti është 314.73 banorë/km². Modeli më i zakonshëm familjar në Vlorë është një familje e përbërë nga katër anëtarë. Jetëgjatësia mesatare është 71.4 vjeç, 68.5 për burrat dhe 74.3 për gratë. Sipas të dhënave nga regjistrimet lokale, mosha mesatare në rajon është 28.6 vjeç.

Në zonat urbane, kryesisht në qytetin e Vlorës janë të regjistruar rreth 71% e popullsisë, ndërsa popullsia në zonat rurale dhe gjysmë urbane (Orikumi), përfshin rreth 29% e popullsisë.




Figura 2. Harta e Planit të Zhvillimit, Bashkia Vlorë

NJA	Banorë	Familje	Banesa
Vlorë	144744	48751	38,935
Orikum	11953	3654	2,305
Novoselë	17361	4868	3,060
Qendër	18937	5294	3,330
Shushicë	9756	2917	1,800
Total	202,751	65,484	49,430

Tabela 2. Demografia, Bashkia Vlore

Karakteri turistik i zonës ka çuar në zhvillimin e madh të shtëpive të para e të dyta, si dhe të shërbimet e turizmit përgjatë zonës bregdetare. Kjo pasqyrohet në luhatjet e larta sezonale të popullsisë të lidhura me ekonominë e turizmit. Është vlerësuar se, popullsia aktuale e qytetit dhe zona periurbane në sezonin e verës, duke përfshirë edhe emigrantët e kthyer, ka një rritje të dyfishtë. Ky trend ka shënuar një ndryshim të shpërndarjes territoriale të popullsisë, nga ajo malore në zonat bregdetare dhe nga perëndimi në jug.

Gjatë një pjese të vitit, kryesisht në dimër Vlora ka një përgjysmim të numri të banorëve rezident¹ për arsye të emigracionit dhe migrimit të brendshëm, por gjatë sezonit të verës ka mjaft qytetarë të kthyer, turista apo vizitorë të përditshëm e sezonal që e ndryshojnë përbërjen e popullsisë. Aktualisht në qarkun e Vlorës banon vetëm 49% e popullsisë së regjistruar. Popullsia gjatë sezonit të turizmit për Bashkinë Vlorë në bazë të dhënave zyrtare (Burimi INSTAT 2016) shprehet si më poshtë.

Indikatorët	Bashkia Vlora
Popullsia rezidente	104827
Popullsia e rikthyer në periudhën e verës	55032
Pronarët e banesave të destinuara për qëllime dytësore	22692
Turistët (në ditë)	3000
Visitorë ditorë	9000
Të punësuarit sezonalë	1700
Totali	196251

Figura 2. Përlogaritja e popullsisë së turizmit

Shpërndarja e popullsisë së përhershme i referohet në pjesën më të madhe zonave ekzistuese urbane. Qyteti i Vlorës zë vetëm 45% të sipërfaqes totale të tokës urbane pavarësisht nga fakti se, në të përqëndrohet 71% e popullsisë.

Sipas INSTAT Censusi i 2011 në bashkinë Vlorë ka patur rreth 14,726 banesa stok ndërkohë aktualisht ka 16,269 ndërtime stok² në dispozicion për të absorbuar rritjen e popullsisë.

¹ INSTAT 2019, Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2019

² Plani i Përgjithshëm Vendor Vlore 2017

Vitet e fundit, 2015-2018, zona veriore e bashkisë Vlorë është kërcënuar nga përmytjet nga lumenjtë Seman dhe Vjosë. Dëmet e vërejtura janë përmytje radhazi të mijëra hektarë tokë bujqësore e punueshme, disa qindra biznese dhe ndërtesa.




Figura 3. Harta e përmbytyjeve në zonën e Vjosës 2015-2018

Në qarkun e Vlorës raportohet 52% e dëmit total të regjistruar në shkallë vendi. Ndikimi më i madh i bëhet tokës së punueshme, për të vazhduar me dëmet në shtëpi dhe diga e argjinatura. Banorë të evakuuar në përmbytjet e 2017 nga Vlora janë rreth 125 familje.




Figura 4. Dëmet në banesa dhe toka nga përmbytjet

2.2 Papunësia

Referuar Census-it 2011 papunësia në bashkinë Vlorë është rreth 27.0%, pak më e ulët krahasuar me nivelin kombëtar 29,3%. Po kështu niveli i papunësisë midis të rinjve në nivel bashkie është 51.5%, kundrejt 52.9% në nivel kombëtar. Niveli i papunësisë është edhe më i lartë në qytetin e Vlorës në krahasim me NJ.A të tjera nga fakti i zhvendosjes së popullsisë drejt qytetit. Gratë janë më të diskriminuara nga pikëpamja e punësimit, ato përbëjnë 31,5%, krahasuar me burrat që janë 24.3%.

Ndërsa në vitin 2018 papunësia në total në qarkun Vlorë ishte 21.9%, shumë më e lartë se niveli kombëtar prej 12.3%. E parë kjo nga pikëpamja gjinore rezulton që 26.2% janë gra, dhe 18.7% e të papunëve janë burra.

Viti	2017	2018
Nr total i te papunëve	21.242	22.083
Shkalla e papunesisë (%)	23.9	21.9
Gra	10.067	11.224
Burra	11.176	10.860

Tabela 2. Papunësia në vite në Bashkinë Vlorë

2.3 Punësimi

Punësimi dhe shpërndarja e të punësuarve në bashkinë e re të Vlorës sipas Tregut të punës 2018 (INSTAT), llogaritet sipas tre sektorëve më të rëndësishëm që janë:

- sektori i industrisë me 23% (18.439);
- sektori i bujqësi/agrikulturës me 33% (25.727)
- sektori i shërbimeve me 44% (34.647).




Figura 5. Punësimi sipas sektorëve

Qarku i Vlorës ka një rritje të të punësuarve nga viti 2017 në 2018. Raporti i fundit nxjerr 78,814 individë të punësuar, kundrejt 67,625 individëve të një viti më pare. Nga pikëpamja gjinore 31,579 gra dhe 47,235 janë burra.

Viti	2017	2018
Nr total i të punësuarve	67,625	78,814
Shkalla e punësimit (%)	44.9	49.7
Gra	26.608	31,579
Burra	41.017	47,235

Tabela 3. Punësimi në vite

Njësitë Administrative që kanë nivelin e punësimit shumë më të ulët dhe nxjerrin në pah dhe diferenca sociale të mëdha, janë **Novosela me 26.2%** dhe **Shushica me 30.9%**. Nga publikimet e INSTAT, të ardhurat mesatare (bruto) të një të punësuarit në Shqipëri, për tre mujin e fundit të vitit **2018** janë **52,312 lekë (430EUR)**. Krahasuar me tre mujin e fundit të vitit 2015 vëmë re një rritje me 10.2%. Figura e mëposhtme paraqet në mënyrë grafike të ardhurat mesatare nga viti 2015-2018.




Figura 6. Paga mesatare bruto në Shqipëri, vitet 2015-2018

2.4 Sektorë të rëndësishëm të ekonomisë

Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm në drejtim të zhvillimit ekonomik, i cili rezultoi me uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike. Kriza globale financiare që goditi Shqipërinë pas vitit 2008 rezultoi me rënie ekonomike, duke arritur nivelin e saj më të ulët në 2013 me 1.0% rritje të PBB-së reale. Rritja ekonomike filloi të përmirësohej në vitet e tjera dhe arriti në 3.8% në 2017. Sidoqoftë, PBB për frymë është shumë më e ulët në Shqipëri sesa BE-28. Në vitin 2017, PBB-ja për frymë e Shqipërisë ishte 4,024 EUR krahasuar me 27,780 EUR e BE-28. Sektorët ekonomik kryesor që kontribuojnë në rritjen ekonomike të Bashkisë Vlorë janë shërbimet në funksion të turizmit, bujqësia dhe industria.

2.4.1 Zhvillimi industrial

Potencialet e zhvillimit industrial në qytetin e Vlorës lidhen padyshim me pozicionin gjeografik, portin, burimet natyrore si naftë, gaz natyror, bitum dhe kripë dhe forcën



punëtorë të kualifikuar. Burimet natyrore krijojnë mundësi për të zhvilluar degë të tilla si industri nxjerrëse dhe përpunuese, peshkim, manifakturë, tekstile, ndërtim si dhe potencial të lartë për zhvillim të energjisë së rinovueshme.

Në Nj.A. Novoselë ka një fabrikë të prodhimit të kripës, e cila në të ardhmen mund të rrisë kapacitetet e saj të prodhimit dhe përpunimit dhe të eksportojë në vende të tjera.

2.4.2 Zhvillimi i turizmit

Pozicionimi gjeografik i territorit të Bashkisë Vlorë veçanërisht me zgjerimin e saj që nga grykëderdhja e Vjosës e deri në malësinë e Llogorasë, kanë shtuar mjaft larmishmërinë dhe potencialin turistik të saj. Lagia nga dy dete Joni dhe Adriatiku, ekzistenca e shumë monumenteve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, e identifikon këtë territor si zonë me potenciale të spikatura të zhvillimit të turizmit balnear, agro-turizmit, aktiviteteve të peshkimit turistik, etj. Zhvillimi i turizmit është ndër burimet më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, ku turizmi bregdetar kombinohet mjaft mirë me turizmin kulturor. Nga ana tjetër ky sektor në nivel kombëtar bën pjesë në grup aktivitetin e tretë së bashku me tregtin dhe transportin (me 20%) ku gratë janë të punësuar, ndërsa për burrat është sektori i dytë (me 28.8%). Gjithsesi në ekonomitë e vogla familjare gratë janë të vetëpunësuar në agroturizëm.

2.4.3 Bujqësia

Zonat rurale të Bashkisë Vlorë janë të orientuara drejt prodhimit lokal bujqësor. Niveli i lartë i prodhimeve bujqësore, kryesisht frutikulturë, ka ngritur punishte ose fabrika të prodhimit të vajit të ullirit dhe fabrika të prodhimit të lëngjeve, përpunimit të rrushit për verë, raki, etj. Për momentin aktivitetet prodhuese punojnë me lëndë të parë nga importi, por mund të mbështeten me zgjerimin e frutikulturës. Ka edhe ekonomi të prodhimit të verës dhe rakisë të karakterit artizanal (sipërmarrje të vogla ose familjare) ku gratë janë të punësuar kryesisht në to. Këto të dhëna mbështeten edhe nga studimi Burra dhe Gra në Shqipëri në 2018, ku gratë në nivel kombëtar janë të punësuar më së shumti në bujqësi me 42.5%. Gjithashtu NJ.A Novoselë, Shushicë dhe Qendër kanë fertilitetin më të madh të tokës, rrjedhimisht dhe rezerva të larta për zhvillimin e bujqësisë e sidomos në kultivimin e mbjelljen e uulinjve.

2.5 Furnizimi me ujë

Qyteti Vlorë - Rrjeti i shpërndarjes së ujit të pijshëm është shumë i amortizuar. Nëpërmjet investimit hollandez prej 24 milion euro është mundësuar depo e madhe e ujit me kapacitet 6000m³ së bashku me rrjetin shpërndarës.

Njësia Administrative Qendër - Situata e ujit të pijshëm në të gjithë fshatrat e kësaj njësie paraqitet mjaft e rënduar. Rrjeti shpërndarës është i amortizuar dhe vende vende vërehen tubacione plastike të reja. Natyrisht uji nuk konsumohet për t'u pirë.

Njësia administrative Shushicë - Rrjeti i ujësjellësit është tepër i amortizuar për gjithë njësinë Shushicë, pavaresisht se ka burime shumë të mira ujore.

Njësia administrative Novoselë - Kjo njësi identifikohet si një zonë ujëmbajtëse me kapacitet të lartë të mundësive të prodhimit të ujit të pijshëm jo vetëm për nevojat e popullatës, por edhe me mundësi të furnizimit të fshatrave të Njësisë Qendër si dhe qytetit të Vlorës.

Njësia administrative Orikum - Ujësjellësi i ri furnizon me ujë 24 orë Orikumin Qendër,

Radhimë, Dukatin e Ri, Tragjas pjesërisht. Stacioni i pompimit të ujit pranë repartit ushtarak për bonifikimin e tokës është modern por nuk funksionon, duke sjellë uljen e cilësisë dhe pjellorisë së tokës.

Megjithatë në nivel qarku (sipas INSTAT 2011) ka ende banesa që nuk kanë akses në furnizimin me ujë rreth 980 të tilla, ose 3,358 banorë, pjesa më e madhe prej tyre në zonat rurale (71.4%).

1.5.4 Banesat e banuara, numri i NJEF-ve dhe numri i banorëve sipas sistemit të furnizimit me ujë dhe zonës urbane dhe rurale
1.5.4 Inhabited dwellings, number of private households and number of occupants by water supply system and urban and rural area

Sistemi i furnizimit me ujë Water supply system	Zona urbane dhe rurale, banesat e banuara, numri i NJEF-ve dhe numri i banorëve Urban and rural area, inhabited dwellings, number of private households and number of occupants								
	Gjithsej Total			Urbane Urban			Rurale Rural		
	Banesat e banuara Inhabited dwellings	Numri i NJEF-ve Number of private households	Numri i banorëve Number of occupants	Banesat e banuara Inhabited dwellings	Numri i NJEF-ve Number of private households	Numri i banorëve Number of occupants	Banesat e banuara Inhabited dwellings	Numri i NJEF-ve Number of private households	Numri i banorëve Number of occupants
Gjithsej Total	50 556	50 961	174 545	33 213	33 520	114 166	17 343	17 441	60 379
Rrjet ujësjellësi brenda banesës Piped water in the dwelling	38 911	39 239	133 376	29 626	29 891	101 118	9 287	9 348	32 258
Rrjet ujësjellësi jashtë banesës, por në ndërtesë Piped water outside the dwelling, but in the building	5 255	5 290	19 031	1 993	2 013	7 201	3 262	3 277	11 830
Rrjet ujësjellësi jashtë ndërtesës Piped water outside the building	3 011	3 044	10 679	864	883	3 042	2 147	2 161	7 637
Sistemi i llojit tjetër Other system of water supply	2 397	2 401	8 101	474	474	1 854	1 923	1 927	6 247
Pa asnjë lloj sistemi No water supply system	980	987	3 358	256	259	951	724	728	2 407

Tabela 4. Sistemi i furnizimit me ujë, Qarku Vlorë

2.6 Furnizimi me energji

Furnizimi me energji bëhet nga i vetmi operator që vepron në Shqipëri OSHEE sh.a. Nga 1 janari 2020 është krijuar shoqëri bijë e OSHEE dhe furnizimi i klientëve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi realizohet nga **Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A** (FSHU Sh.A).

Bashkia Vlorë aktualisht mbulon nevojat për energji nga:

- Nënstacioni Vlora 1,
- Nënstacioni Vlora 2
- Nënstacioni Uji i Ftohtë,
- Nënstacioni Skele,
- Nënstacioni Smokthinë
- Nënstacioni Gorisht.

Njësia Administrative Qendër ka problematikë lidhur me rrjetin shpërndarës ashtu edhe me parametrat që ofrojnë linjat e elektrikut. Në të gjithë zonën situata e rrjetit elektrik është në gjendje jo të mirë, duke u përkeqësuar edhe më shumë vitet e fundit për arsyen e mbingarkimit të rrjetit nga ndërtimet informale si shtëpi, ndërtesa industriale etj.

Njësia Administrative Shushicë Rrjeti ekzistues 35/10 i energjisë elektrike është i dobët dhe me probleme, pritët të zbatohet projekti i OSHEE-së për rrjetin e ri 6 Kv me qendër në Xhyherinë.

Njësia Administrative Novoselë aktualisht furnizohet me energji nga rrjeti 35/10 kv në Mifol.

Njësia Administrative Orikum furnizohet me energji elektrike nëpërmjet nënstacioneve:

- Nënstacioni Radhime 35/10 kv
- Nënstacioni Orikum 35/6 kv

2.7 Ngrohja e banesave

Bazuar në studimin e Bankës Botërore mbi Ngrohjen nga Biomasa për Ballkanin Perëndimor, në Shqipëri 94% e ndërtesave kanë sistem individual ngrohjeje, dhe më pak se 1% nuk kanë fare ngrohje. Në Shqipëri nuk ka sistem qendror ngrohje nga qyteti. Kryesisht ngrohja e banesave realizohet nga energjia elektrike 62%; me dru zjarri (dhe pelet) 20% dhe me gaz 8%.




Figura 7. Infrastruktura e energjisë në Vlorë





Figura 8. Sistemi i ngrohjes në Ballkanin Perëndimor

Sipas po këtij studimi shpenzimet mesatare vjetore për ngrohje dhe energji në nivel familje janë rreth 829 EUR, ose 10.4% e shpenzimeve të të ardhurave vjetore në rajonin e Ballkanit Perëndimor, gjë që flet për varfëri energjitike (përcaktuar në raport si "shpenzim energjie që përfaqëson të paktën 10% e të ardhurave familjare") në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Mal të Zi, dhe Serbi. Ky studim po ashtu sugjeron që të konsiderohet ndikimi tek konsumatorët i cdo mase që afekton totalin kostos së energjisë.



Sources: Annual household expenditures in the W-B: from the last available Household Budget surveys of W-B countries, adjusted for the inflation rate. Expenditures for heating: ECO, *Assessment of the Residential Energy Efficiency Investment Potential in the Western Balkans*, 2015. Expenditures for electricity: consultant estimates based on electricity consumption in the residential sector in the W-B countries.

Figura 9. Kufiri i varfërisë energjitike në Ballkanin Perëndimor

Në nivel qarku, sipas INSTAT 2011, lloji kryesor i ngrohjes që përdorin familjet në Qarkun e Vlorës është:

1.4.10 Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale
1.4.10 Private households by main type of energy used for heating and urban and rural area

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje Main type of energy used for heating	Zona urbane dhe rurale Urban and rural area		
	Gjithsej Total	Urbane Urban	Rurale Rural
Gjithsej Total	50 961	33 520	17 441
Dru Wood	18 277	6 280	11 997
Energji elektrike nga rrjeti Electricity from the grid	11 344	9 709	1 635
Gaz Gas	12 775	10 980	1 795
Lloj tjetër energjie (panel dielloz, qymyr, naftë, etj) Other type of energy (solar panel, coal, oil, other)	276	174	102
Pa ngrohje No heating	8 289	6 377	1 912

Tabela 5. Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje, Qarku Vlorë

Nga tabela jepet qartë që në zonat rurale pjesa më e madhe e familjeve përdorin ngrohjen me dru, ndërsa në zonat urbane ngrohja realizohet me energji elektrike dhe me gaz. Në ditët e sotme energjia elektrike mbetet ende në nivele të larta përdorimi. Po ashtu edhe humbjet në rrjet janë të mëdha (25%) edhe pse nga viti në vit janë ulur.




Figura 10. Konsumi i energjisë dhe humbjet në rrjet

Aktualisht mbulohet me shërbim energjie elektrike e gjithë Bashkia Vlorë, përveç një fshati në Dhërmi që nuk ka banorë. Rezultojnë 83,665 abonentë, ku nga këto 72,141 janë familje (86%). Pagues të rregullt të faturave janë rreth 64% e klientëve. 25,868 janë familje debitoare (rreth 36% e totalit të klientëve familjarë) ndaj OSHEE duke mos mundur dot të paguajnë detyrimin, kryesisht për shkaqe ekonomike; ndërsa 14,501 abonentë familjarë janë të larguar apo kanë një konsum tepër të ulët. Mesatarja e konsumit mujor për familje është 162 kWh, e konvertuar në kosto është rreth 1,830 lekë. Nga sistemi i OSHEE nuk mund të nxirren të dhëna mbi madhësinë e familjeve, gjininë, apo aspekte të tjera sociale. Ndërkohë po t'i krahasojmë këto të dhëna me mesataren në nivel kombëtar të energjisë elektrike të përdorur nga klient familjarë (figura 11) shohin se kjo vlerë është rreth 400

kWh/muaj. Pra qartazi duket që në Vlorë konsumi është shumë më ulët se mesatarja kombëtare (40%) gjë që tregon për shkallën e informalitetit dhe për besueshmërinë e të dhënave në vitin 2013.




Figura 11. Përdorimi i energjisë elektrike në sektorin familjar, 2013

Ndërsa nga të dhënat e ERE-s (raporti vjetor për 2018) konsumi mesatar mujor në nivel kombëtar për klient familjarë është rreth 211 kWh (tabela 6). Përsëri Vlora paraqitet me një mesatare më të ulët (rreth 23%) që është tregues i një zhvillim të ulët, mungesë të teknologjisë, mungesë të industrisë, e pse jo edhe një tregues i varfërisë në zonë.

Viti	Kliente familjar ne total	konsumi vjetor per Familjet (MWh)	konsum kWh/klient/muaj
2018	1,059,382.00	2,681,848.00	210.96

Tabela 6. Të dhëna për konsumin e energjisë elektrike për klientë familjarë

Burimi: autori

Vitin e fundit kanë patur rreth 150 raste të lidhjeve të jashtëligjshme të energjisë, të cilat janë denoncuar nga OSHEE Vlorë pranë organit të prokurorisë së rrethit gjyqësor Vlorë.

Mbulimi me shërbim Vlorë	Nr i abonentëve (Biznese)	Nr i abonentëve (Familje)	Pagesa të rregullta (Familje)	Debitore (Familje)	Pa konsum/konsum i ulët
100%	11,524 (14%)	72,141 (86%)	31,772 (64%)	25,868 (36%)	14,501 (20%)

Tabela 7. Të dhëna për furnizimin me energji elektrike

Burimi: OSHEE, Vlorë

3. Identifikimi i familjeve në varfëri energjitike

Energjia është një sektor strategjik me rëndësi jetike për ndriçimin, mbrojtjen nga të ftohtit dhe transportin e njerëzve dhe mallrave, si edhe për të mbështetur të gjithë sektorët e ekonomisë – bujqësisë, industrisë dhe shërbimet—si dhe progresin shkencor.

Garantimi i energjisë së sigurt me çmim të përballueshëm është një nga sfidat më të mëdha me të cilën shtetet evropiane po përballen aktualisht. Integrimi i mëtejshëm i politikave kombëtare me ato evropiane të energjisë, sidomos dimensionit social dhe ai gjinor si dhe të folurit njëzëri në skemën globale është vendimtar drejt suksesit.

Që në 2006 Shqipëria është pjesë e Komunitetit të Energjisë e detyruar të përmbushë detyrimet nga ky anëtarësim. Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MEI) është organi kompetent për hartimin e legjislacionit dhe për raportimet në Komunitetin e Energjisë.

Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike, në nenin 7 të saj, citon se: "Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate për të mbrojtur konsumatorët dhe do të sigurojnë marrjen e masave adekuate mbrojtëse për të mbrojtur konsumatorët e cënueshëm. Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar do të përcaktojë konceptin e konsumatorëve të cënueshëm, i cili do t'i referohet varfërisë dhe midis të tjerave duhet të ndalojë ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorët në raste kritike". Neni 8, i po kësaj Konvete parashikon se: "Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate sikundër janë formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energjinë, që sjell përfitime në sistemin e sigurimit social dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm të energjisë për konsumatorët e cënueshëm apo ofrimin e përkrahjes për përmirësimin e efikasitetit të energjisë...".

Në vitin 2015 është miratuar ligji Për sektorin e energjisë elektrike (Ligj nr. 43/2015). Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Tarifimi i energjisë elektrike nuk ka më përshkallëzime të çmimit të energjisë elektrike për familjarët me dy nivele, nën dhe mbi 300 kWh, dhe të gjithë konsumatorët familjarë paguajnë 9.5 lekë për kWh pa tvsh. Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kWh në muaj, KM ka miratuar një vendim të posaçëm i cili kompenson diferencën e çmimit të energjisë elektrike për mbrojtjen e këtyre shtresave (VKM nr. 8, datë 14.1.2015).

Varfëri energjitike është situatë në të cilën një familje nuk mund të aksesojë shërbimet energjitike në shtëpi në një nivel të atillë që të mund të përballojë nevojat e saj sociale dhe materiale.

Sot, kur nuk ka një kategori sociale të mirë përcaktuar nga pikëpamja ligjore se kush ndodhet në kushtet e varfërisë energjitike, është e vështirë të përcaktohet nëse një familje është ose jo në varfëri energjitike. Në ligj gjendet vetëm koncepti "*Klient në nevojë*" - një klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Në nenin 95 sanksionohet që Ministria përgjegjëse për çështjet sociale (aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Financave, dhe në konsultim me ERE-n e grupet e interesit, harton



kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë marrin në konsideratë:

- a) klientët me të ardhura më të ulëta, të cilët e përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit tyre të përhershëm;
- b) klientët që kanë konsum të energjisë elektrike të lidhur në rrjetin njëfazor me një fuqi maksimale prej 16 amper;
- c) nivelin maksimal të konsumit të energjisë për person, në varësi të sezonit;
- ç) mënyrën e përkrahjes së drejtpërdrejtë nga Buxheti i Shtetit.

Sipas ligjit klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, regjistrohen në një regjistër të veçantë nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale. Ky informacion i dërgohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit të energjisë elektrike. Nëse për shkak të ndryshimit të rrethanave, klienti humb statusin e klientit në nevojë, struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale e heq nga regjistri i klientëve në nevojë dhe njofton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesin. Të dhënat e klientit të hequr nga regjistri i klientëve në nevojë duhet të ruhen për një periudhë prej 5 vjetësh pas gregjistrimit.

Gjithsesi shkalla e lehtësisë nuk është e pafundme. Sipas rregullores, klientit në nevojë do t'i ofrohet një plan pagese, që i përshtatet të ardhurave të tij. E vetmja mundësi që klientit në nevojë i ndërpritet energjisë është nëse ofruesi i shërbimit, në këtë rast OSHEE, i ka ofruar dy herë një plan pagese që përshtatet me të ardhurat e klientit ose asistencë pagese, në kuadër të statusit si "klient në nevojë" dhe nuk është zbatuar.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale të gjitha familjet që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, përfitojnë disa lehtësira përsa i përket detyrimeve ndaj OSHEE-së. Po ashtu, bazuar në VKM nr.8, datë 14.01.2015 "Për mbrojtjen e shteresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj" kjo kategori familjesh përfiton kompensim financiar për energjinë elektrike në masën 1288 lekë të rinj, në muaj".

Komisioneri i mbrojtjes nga diskriminimi pas kërkesave, ankesave të bëra nga qytetarë ka arritur në përfundimin se: ka mungesë të akteve nënligjore për kriteret dhe procedurën për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, parashikuar të përfundonte brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit nr 43/2015.

Në kushtet aktuale shumë më tepër familje duhet të përfitojnë statusin e klientit në nevojë, pasi:

- Rritja e çmimit të energjisë elektrike është më e lartë në krahasim me rritjen e të ardhurave
- Pamundësi për të siguruar energji me çmim më të ulët
- Nevoja në rritje për energji
- Mungesa e efikasitetit në përdorimin e energjisë
- Ndërhyrjet e politikave

Deri më sot edhe pse programet sociale janë hartuar, nuk i kushtohet një fokus i veçantë grave, ose nuk përfshihen elementë që do të theksonin veçanërisht çdo mbështetje ose fuqizim të grave.

Janë shumë faktorë që përcaktojnë nëse një familje përballet ose jo me efektet negative të këtij fenomeni:

I. Faktorët ekonomik dhe socio-demografik

- Demografia

Numri, Gjinia, mosha e anëtarëve të familjes

- Aspektet finaciare

Të ardhurat, shpenzimet për energji

- Shëndeti

Mendor, Fizik

II. Faktorët energjitik

- Vlerësimi i klasës energjitike dhe treguesit ilustrues

Izolimi, lagështia, myku, rryma e ajrit, sistemi i ngrohjes

- Shërbimet energjitike

Ngrohja, freskimi, uji i ngrohtë në shtëpi, gatimi, ndriçimi, larja, të tjera

Nga sa më sipër në bashkinë Vlorë përveç 726 familjeve (rreth 1.2% e totalit) që kanë fituar statusin e NE, janë dhe rreth 36% e familjeve që rezultojnë debitorë pranë OSHEE janë kandidatë për të fituar statusin e klientit në nevojë. Kriteret e vendosura për të fituar statusin e NE janë shumë të forta duke zvogëluar ndjeshëm nr e familjeve përfituese sidomos atyre të zonave rurale. Nga të dhënat e marra nga zyra e vendore e OSHEE-së është e vështirë që të dhënat të jenë të disagreguara sipas madhësisë së familjes apo veçorive të tjera gjinore, të klientit në nevojë që të mund të arrinim në të dhëna më të plota.

3.1 Familjet e cënuara

Nga një studim i Bankës Botërore³, i kohëve të fundit, vlerësohet se familjet me kryefamiljar të vetëm pensionist, megjithëse jo gjithmonë më të varfër në terma të të ardhurave, janë në risk pasi shpenzojnë një pjesë të mirë të ardhurave për energji (7.7 %). Incidenca e tyre për të rënë në kategorinë e klientit në nevojë është 23%. Familjarët përfitues të assitencës së papunësisë, familjet me fëmijë apo me prindër të vetëm, familjet me kryefamiljar gra, shpenzojnë energji në përqindje më shumë se mesatarja e familjeve në nivel kombëtar. Si rrjedhim përbëjnë grupime të rrezikuara për të qenë pjesë e "varfërisë energjitike".

Programet apo mekanizmat financiar për të subvencionuar energjinë shpesh nuk mbështet këto grupe në nevojë dhe hasin sfida gjatë zbatimit: psh 16% e programit mbështetës akordohet për familjet në kuintilin e poshtëm dhe vetëm 22% prej tyre përfitojnë.

Sipas CENSUS-it 2011, për qarkun Vlorë rreth 5% e familjeve nuk kanë asnjë pajisje elektrike/elektronike afatgjatë apo shërbim duke i kthyer ato në grup lehtësisht të cënuar, ndëkohë që lavatricja, TV, boileri dhe celulari janë nga pajisjet që gjenden në pjesën më të madhe të familjeve.

³Western Balkans: Directions for the Energy Sector Final Report June 2018

1.4.11 Njësitë Ekonomike Familjare sipas zonës urbane dhe rurale, pajisjeve afatgjata dhe shërbimeve dhe numrit të antarëve të familjes
1.4.11 Private households by urban and rural area, household amenities and number of household members

Zona urbane dhe rurale, pajisjet afatgjata dhe shërbimet Urban and rural area, household amenities	Numri i antarëve të NJEF-së Number of household members			
	Gjithsej Total	1-2	3-4	5+
Frigorifer Refrigerator	48 043	16 099	20 169	11 775
Ngritës Deepfreezer	3 841	1 104	1 734	1 003
Lavatriçe Washing machine	43 703	14 067	18 729	10 907
Tharës robash Drying machine	1 307	311	635	361
Makinë pjatlarëse Dishwasher	1 673	409	844	420
Boiler elektrik Boiler	20 084	6 428	8 889	4 767
Mikrovalë Microwave oven	9 553	2 636	4 654	2 263
TV TV	46 355	15 484	19 477	11 394
TV dekoder TV decoder	9 576	2 487	4 534	2 555
Telefon fiks Fixed telephone	15 510	5 359	6 688	3 463
Celular Mobile telephone	42 985	13 376	18 623	10 986
Kompiuter Computer	8 819	1 248	4 980	2 591
Lidhje interneti Internet connection	5 367	746	3 119	1 502
Panel diellor Solar panel	1 177	317	528	332
Kondicioner Air conditioner	6 150	1 753	3 003	1 394
Makinë Car	14 659	2 334	7 419	4 906
Asnjë nga këto None of these	2 355	1 020	833	502

Tabela 8. NJE familjare, pajisjet afatgjata dhe shërbimet, dhe numri i personave në familje, Qarku Vlorë

3.1.1 Familje në ndihmë ekonomike

Bashkia Vlorë numëron rreth 57,260 familje nga të cilët 726 familje (1.2%) përfitojnë ndihmë ekonomike, 450 tetraplegjike dhe të verbër të grupit të parë si dhe 6,600 pensionistë. Të ardhurat që personat me status NE marrin janë mesatarisht 1,800 lekë/person. Nga totali



Figura 12. Aspekete sociale nga pikëpamja gjinore

i familjeve me NE, 208 prej tyre janë gra kryefamiljare, ndërsa për personat me aftësi të kufizuar që përfitojnë ndihmë ekonomike janë 689 gra dhe 1,584 burra.

Ndërsa në NJA Novoselë (nga të dhënat e marra nga specialist i NE pranë kësaj NJA) 48 familje përfitojnë ndihmë ekonomike nga 4,900 familje në total dicka më pak se 1%; 13 familje i përkasin komunitetit rom, të cilët kanë edhe kushtet më të rënduara të banesave. 379 personat me aftësi të kufizuar, kryesisht tetraplegjike, të verbër dhe invalid pune përfitojnë gjithashtu ndihmë ekonomike.

Kategoria	Qyteti Vlorë		NJA Novoselë		NJA Shushicë	
Ndihmë Ekonomike	TOTALI	GRA	TOTALI	GRA	TOTALI	GRA
	509	275	110	62	116	86
PAK	TOTALI	GRA	TOTALI	GRA	TOTALI	GRA
	1131	495	110	67	113	40

Tabela 9. Familjet në NE dhe PAK sipas gjinisë në zona rurale dhe urbane.

3.1.2 Komuniteti rom dhe egjiptian

Në bashkinë Vlorë ka një komunitet rom rreth 190 familje, rezidente përkatësisht: 60 familje në fshatrat Novoselë, 20 familje në Akërnë, rreth 90 familje në Llakatund dhe rreth 20 familje në qytetin e Vlorës.

Ndërsa komuniteti egjiptian është vendosur në Rajonin Administrativ Nr. 1, me rreth 400 familje në afërsi të lagjes Partizani. 71% e tyre pranojnë se kanë shtëpinë e tyre, ndërkohë që 29% nuk zotërojnë një shtëpi. Egjiptianët gjatë periudhës së komunizmit kanë qenë të mirë integruar në jetën e qytetit, ndërkohë që ndryshimet e viteve '90 shfaqën problemin e papunësisë në mënyrë masive për këtë komunitet. Numri i romëve që jetojnë në qytet është shumë i kufizuar. Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Vlorë rezulton se në Bashkinë Vlorë jetojnë 19 individë nga komuniteti rom, prej të cilëve 1 fëmijë 1-5 vjeç, 11 fëmijë të moshës 5-14 vjeç dhe 7 të moshës madhore. Këta individë janë të ardhur kryesisht nga zonat rurale përreth Bashkisë së Vlorës.

Sipas **Drejtorisë së Shërbimit Social** pranë Bashkisë së Vlorës rreth 75% e familjeve në total përfituese të ndihmës ekonomike janë familje egjiptiane. Kjo tregon varësi të këtij komuniteti kundrejt ndihmës ekonomike. Sektorët bazë të punës përqendrohen në shërbimin e pastrimit dhe gjelbërimit.

(Burimi: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/Plani-Vlore-Novosele-final-25qershor-3.pdf>)

Komuniteti rom në NJA Novoselë

NJA Novoselë, pjesë e Bashkisë Vlorë, përfshin 12 fshatra: Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërnë. Ajo ka një popullsi prej rreth 17,400 banorë. Ndodhet në veri të qytetit të Vlorës dhe kufizohet në veri me rrethin e Fierit, me vijë ndarëse lumin Vjosë, në lindje me NJA Shushicë, në jug me NJA Qendër, dhe në perëndim laget nga ujërat e detit Adriatik.

NJA Novoselë ka numrin më të lartë të komunitetit rom në shkallë vendi, i përqëndruar kryesisht në fshatin Akërnë dhe Novoselë. Në fshatin Akërnë jetojnë rreth 28 familje rome



dhe në fshatin Novoselë rreth 57 familje ose 310 banorë. Rreth 23% e tyre përfitojnë NE. Edhe ky komunitet është prekur ndjeshëm nga fenomeni i emigrimit (kryesisht drejt Greqisë).

Për familjet që vazhdojnë jetojnë në fshat **burimet kryesore të të ardhurave** janë bujqësia, blegtoia, punësimet e rastësishme/sezonale, remitancat nga të emigruarit si dhe fitimet e pakta që gjenerohen nga riciklimi i mbetjeve. Mungesa e të ardhurave apo të ardhurat e pamjaftueshme gërshetohen me problematika të strukturës familjare të cilat shpesh e rëndojnë më tej situatën. Shumë prej familjeve kanë probleme me zyrtarizimin e martesave, njohjen e atësisë dhe detyrimeve përkatëse, jetesën e fëmijëve larg prindërve, etj. Papunësia është fjala kyç që dëgjon nga përfaqësuesit e këtij komuniteti. Përveç mundësive të kufizuara për sigurimin e një pune dhe veçanërisht garantimin e vijueshmërisë së saj.

Strehimi dhe infrastruktura e zonave ku është vendosur komuniteti rom në Novoselë u identifikuan gjithashtu si një fushë/problematikë prioritare. Edhe pse pjesa dërmuese e komunitetit raporton të zotërojnë banesë (85%), kushtet në të cilat janë këto banesa janë shumë problematike duke filluar që nga cilësia e punimeve (një pjesë jetojnë në shtëpi balte) duke vijuar me kushtet teknike dhe higjieno-sanitare të tyre. Është pikërisht në këto banesa pa standarde dhe me kushte të vështira ku jetojnë kryesisht familje të mëdha. Rreth 82% e tyre jetojnë në familje me pesë ose më shumë anëtarë.

Komuniteti rom dhe egjiptian në NJA Shushicë

Në **NJA e Shushicës** janë të regjistruar 464 rom, me një numër total prej 112 familjesh dhe numër fëmijësh nga 0-18 vjeç është 181 (*Burimi: Social Inclusion Data for Children in Albania (2011), Roma Communities*). Këto familje janë të shpërndara si më poshtë: 17 familje janë të vendosura në Njësinë Administrative Novoselë, 6 familje janë të vendosura në qytetin e Vlorës, 1 familje është banore e Njësisë Administrative Qëndër, 43 janë të Njësisë Administrative Shushicë dhe 45 familje banojnë në Njësinë Administrative Novoselë. Po ashtu gjenden dhe 47 familje Egjiptiane me një numër prej 183 personash.

Jeta e banorëve të komunitetit Rom karakterizohet nga **kushte ekonomike** shumë të vështira. Statistikat e sakta në lidhje me shkallën e papunësisë për këtë komunitet mungojnë pasi pjesa më e madhe e tyre nuk kanë informacionin e duhur për t'u regjistruar në zyrat e punës, por ajo vlerësohet të jetë mjaft e lartë. Nga ana tjetër, ka mungesë të theksuar të hapësirave për punësim për Romët, të cilët merren kryesisht me mbledhjen e materialeve të riciklueshme, tregtinë e rrobave të përdorura dhe punët e rastit. Për familjet që vazhdojnë jetojnë në fshat burimet kryesore të të ardhurave janë bujqësia, blegtoia, punësimet e rastësishme/sezonale, remitancat nga të emigruarit si dhe fitimet e pakta që gjenerohen nga riciklimi i mbetjeve. Problemet e papunësisë ndikojnë në mosgarantimin e kushteve minimale të jetesës dhe nga ana tjetër çojnë në probleme të rënda sociale e dhunë në familje. Pjesa më e madhe e fëmijëve shoqërojnë prindërit në aktivitetet e tyre të përditshme ose nxirren për të lypur, gjë që përbën rrezik për këta fëmijë të cilët janë të ekspozuar ndaj çdo lloj rreziku. Pavarësisht varfërisë ekstreme, pjesa më e madhe e familjeve Rome **nuk përfitojnë nga skemat e ndihmave** kryesisht si pasojë e faktit që nuk janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile si dhe për shkak të lëvizjes së vazhdueshme nga një vend në tjetrin.

Strehimi dhe infrastruktura është një nga problemet më të ndjeshme pas mungesës së ushqimit për këtë komunitet, pasi shumë familjeve iu mungon strehimi i sigurtë si dhe



kushtet sanitare, por nuk ka statistika të sakta në lidhje me këtë problem. Një pjesë e madhe e tyre strehohen në banesa të improvizuara me dërrasa, llamarina ose çadra të vjetra, në të cilat mungojnë pajisjet elementare, kanalizimet, uji i pijshëm ose instalimet elektrike. Hapësirat e kufizuara të banimit shoqërohen edhe me mbipopullimin e tyre.

3.2 Problemet specifike të zonës me varfëria energjitike

Zona pilot ka disa specifika:

- 250-300 ditë me diell në vit
- Izolimi i dobët: mungon termoizolimi duke qenë se bën një dimër i butë
- Stok i vjetër i ndërtesave dhe ato të reja jo cilësore: shumica e ndërtesave nuk janë të rregulluara plotësisht.
- Sistemet e ngrohjes dhe ftohjes mungojnë.
- Niveli i ulët ekonomik u sjell vështirësi të konsiderueshme në përmirësimin e kushteve të banesave apo në blerjen ose ndërtimin e të rejave.
- Ngrohja në dimër kryesisht me soba druri dhe me energji elektrike për shkak të mungesës së sistemeve qendrore të ngrohjes dhe ftohjes.
- Mungesa e të dhënave dhe informacioneve për varfërinë energjetike dhe aspektet gjinore. Treguesit e vetëm për përcaktimin e këtij fenomeni mund ta marrim nga Zyra e ndihmës ekonomike në Bashki ose nga Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë.
- Mungesa e të dhënave për treguesit e të ardhurave si treguesit kryesorë të varfërisë së energjisë. Kjo pasi jo vetëm përfituesit e ndihmës ekonomike janë të vetmit në varfëri energjetike, por duhet të vlerësohen e merren në konsideratë edhe personat që kanë paga dhe pensione të ulta.
- Papunësia është e lartë dhe burimet kryesore të të ardhurave vijnë nga bujqësia. Problem vazhdon të mbetet paga e ulët.

3.3 Tipet kryesore të varfërisë energjetike dhe grupet e synuara në zonën pilot

Në NJA Novoselë do të punojmë me këto grupe vulnerabël:

- Të moshuarit (pensionistët), kryesisht gra. Pasi ata janë grupi më i prekshëm dhe më i ekspozuar nga varfëria energjetike. Ky grup gjithashtu preket edhe nga aspekti shëndetësor.
- Familje me një prind të vetëm, kryesisht nëna të vetme, beqare.
- Komunitetet etnike (rome, egjiptiane)
- Të papunë dhe të punësuar në rrezik varfërie, kryesisht gra. Familjet me njerëz të papunë janë shumë të prirur ndaj varfërisë energjetike, por shpesh edhe familjet me 1 familjar të punësuar kanë probleme, pasi të ardhurat e ulëta nuk mjaftojnë për sigurimin e shërbimeve themelore të energjisë.

4. Vlerësimi i nevojave të familjeve të cënuara / përfituese të mundshëm

Fokusi dhe prioriteti përgjatë shtrirjes së projektit vlerësohet dhe sugjerohet të jetë zona rurale dhe sidomos grupet më të cënuara si pensionistët, gratë kryefamiljare, komuniteti rom dhe egjiptian si dhe gratë në përgjithësi. Nisur nga kjo, Njësia Administrative Novoselë dhe ajo Shushicë në Bashkinë Vlorë janë NJA që janë më të ekspozuara ndaj varfërisë energjitike dhe ku ka probleme të theksuara sociale dhe më pak vëmendje nga bashkia. Kjo zgjedhje vjen duke studiuar dhe analizuar të gjitha kushtet socio-ekonomike të banorëve, vështirësitë e komunitetit rom, të cilët kanë përqindjen më të lartë të vendbanimit në këte zonë në shkallë kombëtare, dhe aksesit që i'u ofrohen nga ana infrastrukturore e shëndetësore.

Nga takimet me banorët e NJA Novoselë, mësojmë që ato nuk marrin një faturë me të dhënat bazë të shpenzimeve, konsumit në kWh dhe penaliteteve përkatëse, por vetëm një njoftim nga agjenti tatimor me shumën përkatëse. Kjo e bën të vështirë për to për të gjykuar mbi shpenzimin, përdorimin e pajisjeve të ndryshme dhe masat që mund të marrin për reduktimin e konsumit përkatës.




Figura 13. Kopje e mandate të pagesës së EE nga një klient familjar

Në këtë kuadër Milieukontakt i mbështetur nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimet me institucionet vendore në NJA Novoselë, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe intervistat me banorë të zonës do fokusohet në identifikimin e familjeve në varfëri energjetike, vlerësimin e nevojave të tyre, dhe angazhimin e aktorëve të duhur për këtë zonë.

Të dhënat e fundit të INSTAT për vitin 2018 tregojnë se papunësia në bashkinë Vlorë është 21.9%, shumë më e lartë se niveli kombëtar prej 12.3%. E parë kjo sipas gjinisë rezultton që 18.7% e te papunëve janë burra, krahasuar me 26.2% që janë gra. Nj.A që kanë nivelin e punësimit shumë më të ulët dhe nxjerrin në pah dhe diferenca sociale të mëdha dhe pamjaftueshmëri për të paguar dhe përfituar energji elektrike janë Novosela me 26.2% dhe Shushica me 30.9%. Ky nivel i ulët sjell më tej kushtet e vështira të jetesës, probleme në infrastrukturën e banesave, probleme me energjinë elektrike dhe nga i ftohti sëmundje të ndryshme.



Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale Shtetërore Vlorë thuhet që përfituesit e ndihmës ekonomike janë familje që nuk janë të punësuar, kryefamiljare gra, të veja, të divorcuara dhe gratë të dhunuara me urdhër mbrojtjeje. Gjithashtu përfitues të ndihmës ekonomike janë edhe personat me aftësi të kufizuara. Aktualisht në Vlorë janë 726 familje që përfitojnë NE.

Në Njësinë Administrative Novoselë janë aktualisht 48 familje që përfitojnë NE nga 726 familje në total për bashkinë Vlorë. Ndërsa vetëm komuniteti rom ka 13 familje përfituese, të cilat kanë edhe kushtet më të rënduara të banesave. Personat me aftësi të kufizuar që përfitojnë gjithashtu ndihmë janë 379 persona (tetraplegjike, të verbër dhe invalid pune). Kompensimi i shtresave në nevojë me ndihmë ekonomike është 700 lekë/muaj për faturat e energjisë elektrike.

Kryesisht të ardhurat e tyre janë nga bujqesia (vetëpunësim), mbledhja, grumbullimi informal i materialeve të riciklueshme (qelq, alumin, plastike) e shitja e tyre në bizneset e riciklimit dhe shumë pak në ndonjë biznes privat (fabrika përpunimi). Ndërkohë sa vjen e rritet numri i të larguarve, shumë të rinj kanë lëvizur jashtë vendit ose në qytet, ndërsa në shkolla po pakësohet numri i nxënësve.

4.1 Gjinia

Në Bashkinë e Vlorës, gratë janë më të diskriminuara nga pikëpamja e punësimit, ato përbëjnë 26.2%, krahasuar me burrat që janë 18.7%. Nga totali i familjeve që marrin ndihmë ekonomike (726), 208 e tyre janë gra kryefamiljare, ndërsa personat me aftësi të kufizuar që përfitojnë NE janë 689 gra dhe 1584 burra. Për NJA nuk kemi një raport të ndarjes së numrit nga pikëpamja e punësimit në gra dhe burra.

4.2 Shëndeti

Investimet janë pika e dobët dhe e domosdoshme për t'u kryer në të ardhmen për të përmirësuar shërbimin parësor shëndetësor në Shqipëri. Fushat e përmirësimit kanë të bëjnë me pajisjet, medikamentet, dokumentacionin etj. Nga studime të ndryshme del qartë që të gjitha rajonet në Shqipëri kanë nevojë për investime, pasi nuk ka dallime të dukshme midis qendrave shëndetësore. Organizimi i qendrave shëndetësore lën për të dëshiruar në Vlorë në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit specifik por edhe në rregullat e hapjes në orar sipas procedurave.

(Burimi: Monitorimi i shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor në shqipëri 2014, USAID)

Ndërsa kur flasim për komunitetin rom dhe atë egjiptian, të cilët edhe pse nuk janë të vendosur përfundimisht në banesa të përhershme, shërbimi shëndetësor është i pamjaftueshëm. Disa zona të banuara nga Romët nuk kanë akses të mirë në institucionet e shërbimit shëndetësor dhe nuk mund të paguajnë për shërbimet shëndetësore apo ilaçet. Pjesa më e madhe e tyre nuk janë të pajisura me kartela shëndeti dhe fëmijët e këtij komuniteti vazhdojnë të kenë probleme serioze me vaksinimin. Mungesa e higjenës është një problem i cili duhet theksuar dhe adresuar menjëherë. Pavarësisht punës që është bërë nga Drejtoria e Shëndetit Publik, ka nevojë për vijimësinë e ndërgjegjësimit për çeshtje që lidhen me shëndetin dhe higjenën.

Gjatë komunikimeve me Mjekun e Përgjithshëm në qendrën shëndetësore Novoselë

kuptuam që, aktualisht janë 6 qendra shëndetësore që mbulojnë zonën me 13 fshatra. Të punësuar janë një numër relativisht i ulët me rreth 6 mjekë dhe 20 infermierë.

Sëmundjet janë nga më të ndryshmet. Më së shumti janë sëmundjet polmunare (bronkopleomoni), alergjike të stinës, hipertensive dhe anemi të lindura, ku rreth 15-20% e komunitetit është mbartës. I pyetur nëse nga komuniteti rom ka numër më të lartë vizitash, është shprehur që numri është i njëtrajtshëm (përbëjnë 1/3 e vizitave).

Edhe pse të integruar në shoqëri e të kujdesshëm ndaj shëndetit, shpesh ky komunitet preket nga sëmundjet me bronshit, kryesisht fëmijët 3-5 vjec. Vetë doktori pohoi që një nga arsyet e ftohjes është edhe mungesa e energjisë elektrike dhe mungesa e dusheve për ngrohjen e ujit. Stafi i Qendrës Shëndetësore shprehu angazhimin e tyre personal për katër vitet e ardhshme të projektit, tek kartelat që do plotësohen për të sëmurët, të shtohen edhe pyetje/informacion mbi kushtet e banesës. Ato kërkuan nga projekti t'u vihej në dispozicion pyetësori përkatës.

Gjatë vizitës në qendrën shëndetësore, ishte prezente edhe një familje rome që po priste të vizitonte fëmijët. Falë bashkëpunimit me infermierën u bë i mundur intervistimi i tyre.

Rasti në fjalë, ishte një zonjë që kishte 6 fëmijë dhe jetonte vetëm me ndihmën ekonomike prej 8000 lekësh (65eur) që fitonte vetëm ajo. Bashkëshorti ishte i papunë dhe mendohej të siguronte bukën e gojës nëpërmjet punëve informale. Banesa e tyre kishte kushte shumë të vështira, tavani pikonte, dritare alumini me xham tek, lagështi e lartë dhe mungonte termoizolimi. Për gatim përdorej soba e drurit në dimër dhe soba me gaz në verë. Mungonte bojleri për ngrohjen e dushit, ndërsa laheshin me ujë të ngrohur në sobë. Këto muajt e fundit kjo familje kishte rilidhur energjinë elektrike, pasi ishin debitorë ndër vite dhe njëkohësisht shlyenin debinë me




Figure 14. Qendra shëndetësore Novoselë

kamatë vonesë dhe paguanin konsumin mujor. Fatura e fundit kishte ardhur 2,300 lekë, ndërsa debia 1,800 lekë, me një total prej 4100 Lekë. Me një përlogaritje të thjeshtë mbi 50% e NE që përfitonte zonja shkon për faturën e energjisë elektrike.

5. Përqasja për të arritur familjet në nevojë dhe angazhimi i aktorëve të duhur

Milieukontakt synon që përgjatë periudhës së projektit nëpërmjet elementëve si: vizitat në terren, rritjes së kapaciteteve të trajnimeve, advokimeve në nivel vendor, partneritetit me bashkinë Vlorë, ndërgjegjësimin dhe angazhimeve komunitare të adresojë çështjen e varfërisë energjitike, përkatësisë gjinore dhe ndikimit në shëndet. Disa nga rrugët që ne mendojmë të ndjekim përgjatë projektit janë duke:

X. Krijuar partneritete me familjet vulnerabel, organizatat që operojnë prej vitesh në nivel



lokal (World Vision⁴, CRCD, Change) dhe veçanërisht në NJA Novoselë e Shushicë.

- XI. Realizuar workshope për shëndetin, me pjesëmarrjen e stafit të Qendrës Shëndetësore Novoselë e Shushicë dhe angazhuar ata në identifikimin e familjeve në nevojë përmes një pyetësi specifik nga projekti.
- XII. Hartimin e një plan veprimi për të targetuar shtresat në varfëri energjitike në lidhje me performancën e energjisë në banesat e tyre; termoizolimin, konfortin dhe rinovimin e tyre brenda standardeve të efikasitetit.
- XIII. Fokusuar në problematikat e strukturave të banesave, si (lageshtia, myku, termoizolimi, ngrohja, gatimi etj) për të zgjidhur çështjet që lidhen me përballimin e nevojave bazë jetësore për familjet vulnerabel.
- XIV. Lehtësuar komunitetit jetesën për të ideuar dhe zbatuar investime të vogla në banesat që kanë probleme të shumta, kryesisht në furnizimin me energji elektrike dhe lageshtirën.
- XV. Nxatur praktikën e mirë të investimeve (në rastet kur NJA përfshihet në rehabilitime të banesave sociale) për të siguruar standartet minimale jetike në banesa dhe akses të plotë në energjinë elektrike. Në PBA-në 2019-2021 e Bashkisë Vlorë është planifikuar një projekt me vlerë 13,404,776 lekë (75% financim nga Ministria e Energjisë dhe 25% nga Bashkia Vlorë) - rikonstruksioni i 34 banesave (15 në qytetin Vlorë, 12 në fshatin Llakatund, 7 banesa në Akërnë). Sistemi përfshin sistemim çatie, të brendshme, suvatime, dritare dhe lysterje.
- XVI. Universitetet dhe institucionet e tjera kërkimore zhvillojnë studime dhe analizojnë të dhënat e grumbulluara; përgatitjen e auditorëve dhe konsulentëve të ardhshëm të energjisë.
- XVII. Përfshirë anëtarë të komunitetit rom të bashkëpunojnë dhe asistojnë vullnetarët (studentët UNV. Vlorës) gjatë intervistave dhe ekspertët në ndërhyrjet e vogla në terren.
- XVIII. Institucionet publike, kryesisht shkollat 9 vjeçare dhe gjimnaze, duhen edukuar për të bërë pjesë e programeve të gjelbra në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë sesi kursethet energjia elektrike duke përdorur burimet e energjive alternative dhe energjitë e pastra.
- XIX. Lobuar tek pushteti vendor që në ndërtesat publike si shkolla, qendra shëndetësore

⁴ Në bashkinë Vlorë, konkretisht NJA Novoselë vitet e fundit është angazhuar në projekte të ndryshme Organizata World Vision. Ata kryesisht kanë punuar me fëmijet vulnerabel (AK) moshë 2-17 vjeç, por edhe aksesin që ata kanë në shërbime. World Vision ka ngritur programin social "Tungjatjeta...jetë", i cili përmes një ekipi profesionistësh çon shërbimin e specializuar në banesën ku jeton fëmija me Aftësi të Kufizuar.



dhe godina të tjera të agjencive publike të merren masa për të adresuar performancën e energjisë.

- XX. Përmirësuar politikat sociale të cilat ndihmojnë shtresat e familjeve me të ardhura të ulta për përballimin e varfërisë energjitike dhe të zhdukët informaliteti.
- XXI. Stimuluar politika mbi varfërinë energjitike sensitive ndaj gjinsë. Mbledhur të dhëna sipas gjinisë (që mungon jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe vendor). Mospasja e të dhënave = nuk ka vizibilitet; mungesa e vizibilitetit = mungese interesi; mungesa e interesit ndiqet nga mungesa e veprimeve dhe mungesa e përgjegjshmërisë. Klienti në nevojë nuk është një entitet i mirëdefinuar/homegjen dhe është i lidhur në një masë të madhe me gjininë.

Konkretisht mënyra kryesore për të arritur familjet do të jetë komunikimi me qendrat shëndetësore dhe aktorët e tjerë. Aktorët lokal të interesuara janë të gjitha organizatat dhe institucionet që mund të mbështesin fushatën për përfshirjen e familjeve të prekura nga varfëria energjitike ose që mund të sigurojnë ndonjë lloj tjetër mbështetje për zbatimin e projektit EmpowerMed.

- Bashkia Vlorë (NJA Novoselë, NJA Shushicë),
- Qarku Vlorë dhe aktorë të tjerë në nivelin rajonal (zyrat e punësimit),
- Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror,
- Organizatat lokale (Change, CRCO, Tetraplegjikët, Shoqata e Mbrojtjes së konsumatorit Vlorë dhe World Vision),
- Universiteti i Vlorës,
- Qendrat Shëndetësore,
- OSHEE Vlorë.

Milieukontakt së bashku me aktorët e mësipërm do të arrijnë familjet në mënyra të ndryshme. Qendrat shëndetësore dhe organizatat lokale do punojnë drejtpërdrejt me familjet, sidomos ato të prekura nga varfëria energjitike. Kështu që ata do të krijojnë kontakte/takime të drejtpërdrejta me familjet, por edhe përmes fletëpalosjeve.

Aktorët e tjerë do të arrijnë tek familjet përmes takimeve dhe asimilimit të informacionit, prezantimeve që do realizohen për anëtarët e tyre (Shoqata e PAK).

Deri më tani, mënyrat e mëposhtme të përqasjes janë rënë dakord me aktorët lokal:

A. Familjarët

- Informacione në lidhje me faturat dhe leximin e shpenzimeve;
- Realizimin e auditimeve të energjisë në banesa dhe këshilla praktike të tipit DIY
- Në nivel lagje apo fshati të ndërmerret nisma për ndërtimin e një paneli solar për prodhim energjie.

B. Aktorët Social

B.1 Me Qendrën Shëndetësore (Novoselë dhe Shushice) janë planifikuar takime:

- Prezantimi i projektit dhe aktiviteteve për stafin e 6 Qendrave Shëndetësore.
- Stafi i QSH do të promovojë aktivitetet e projektit dhe do integrojë në protokollin e tyre

- 
- plotësimin e një pyetësores të veçantë me pacientët për çdo vizitë që ato do të kryejnë.
- Milieukontakt do të asistojë stafin e QSH për periudha të caktuara kohore gjatë vizitave për evidentimin e familjeve në varfëri energjitike dhe me probleme shëndetësore.

B.2 Me OJFtë janë planifikuar:

- Trajnime në lidhje me varfërinë energjitike dhe ndikimin në gjini dhe shëndet;
- Referime mbi familje në nivel varfërie energjitike, për informacione të mëtejshme;
- Organizimin e tavolinave rajonale për të rënë dakord dhe adresuar mbi dokumentin e politikave që do të hartohet në kuadër të projektit;
- Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit – Të përgatisë një paketë informacioni dhe të drejtash themelore për familjet kur lidhin marrëveshje kontraktuese kompanitë përkatëse.

B.3 Me universitetin e Vlorës është biseduar:

- Angazhimin e studentëve në grupet e audituesve;
- Organizimin e trajnimeve tek disa degë të Universitetit mbi Varfërinë Energjitike, për përgatitjen e auditorëve dhe konsulentëve të ardhshëm të energjisë;
- Për zgjidhjet teknike të mundshme.

C. Pushteti qendror dhe vendor

C.1 Me Bashkinë Vlorë dhe me NJA është biseduar të:

- Marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e projektit dhe
- Ndihmë në identifikimin e zonave më vulnerabël në nivel bashkie;
- Të grumbullojë të dhëna me bazë gjinore dhe të shtojë dhe treguesin e varfërisë energjitike në studimet dhe raportet vjetore që prodhohen;
- Të rregullojë dhe normojë praktika të mira tek investimet (në ndërtime të reja apo dhe rehabilitime të banesave sociale) për të siguruar standartet minimale jetike në banesa dhe akses të plotë në energjinë elektrike.

C.2 Me INSTAT Vlorë është diskutuar mundësia që

- Të përfshihen në formularë që mbledhin informacion dhe tregues për varfërinë energjitike.
- Shkëmbim informacioni me gjetjet tona
- Përfshirje në workshopet e ndryshme që do zhvillohen në nivel bashkie

C.3 Me qarkun Vlorë është biseduar mundësia e:

- Prezantimit të projektit edhe në bashki të tjera të qarkut, sidomos në zonat ku nuk ka akses energjie, ose kur ai është me probleme.
- Shtrirjes së auditimeve për grumbullim informacioni mbi familjet potenciale si 'klient në nevojë' qoftë me vizita në shtëpi apo në qendrat shëndetësore.

C.4 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është biseduar:

- Shkëmbim informacioni i vazhdueshëm;
- Pjesëmarrje e tyre në workshope dhe prezantime të kuadrit ligjor, apo praktikave positive.

6. Informacione shitesë specifike për Rajonin e marrë në studim.

Në qytetin e Vlorës përgjatë viteve 2017-2018 është kryer një studim nga organizata locale CRCD mbi performancën energjitike në ndërtesa përmes konceptit të varfërisë energjitike. Një nga objektivat kryesore ka qenë futja në programet e politikbërjes vendore të investimeve në sektorin e eficientës së energjisë në banesa.

Raporti ka adresuar vlerësimin e performancës së energjisë në sektorin e banesave për Familjet e zakonshme dhe ato në vështirësi ekonomike, institucionet publike si një mjet i vlefshëm për përdorimin e qëndrueshëm të energjisë së pastër.

Në total janë intervistuar 260 individë/familje (nga të cilët 220 familje të rastësishme dhe 40 vulnerabël) dhe 40 institucione publike. Disa nga treguesit e përgjithshëm ishin:

- Moshë mesatare 47 vjeç
- Numri i personave në familje 4-5 persona
- 59% gra-41% burra
- 53% të martuar, 16% të ndarë dhe rreth 30% të pamartuar, bashkëjetues dhe të ve.
- 30% me arsim të lartë, 33% arsim të mesëm dhe 14% me shkollë profesionale
- 53% të punësuar, 11.5% të papunë, 15% në pension, 6.5% shtëpiake dhe pjesa e ngelur të pasiguruar ose të pamundur për të punuar.

Tipet e banesës dhe kushtet e jetesës




Figura 15. Tipet dhe vjetërsia e banesës

Izolimi i dyerve dhe dritareve




Figura 16. Izolimi i dyerve dhe dritareve

Tipi i izolimit




Figura 17. Tipi i izolimit

Mosha e ndertesës dhe izolimi




Figura 18. Vjetërsia e ndërtesës dhe izolimi

Mosha e banesës dhe lloji i ndërtësive




Figura 19. Banesa dhe tipi i xhamave

Problemet me mykun




Figura 20. Problemet me mykun

Përdorimi i energjisë elektrike




Figura 21. Përdorimi i energjisë elektrike

Tarifa mesatare mujore që paguajnë familjet në dimër është 4,491.66 lekë. Tarifa mesatare mujore që paguajnë familjet në verë është 2,524.69 lekë. Tarifa mesatare më e lartë e paguar është 5,077.94 Lek është. 85% e të intervistuarve familjarë kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë.

Tiparet e vlerësuara (izolimi, tipi i xhamave, rrymat e ajrit, lagështia etj) janë të lidhura ngushtësisht si me eficientësinë e një ndërtese ashtu edhe me shëndetin e banorëve. Shëndeti bëhet më tej një faktor ndikues në zhvillimin e aktiviteteve normale jetësore.

Jo më pak se 11% e të ardhurave familjare shkojnë për pagesën e energjisë elektrike dhe kjo kosto prek më shumë familjet dhe shtresat vulnerabel të cilët kanë vështirësi në pagesën e faturave të energjisë dhe si rrjedhim kufizojnë edhe përdorimin e saj për të plotësuar nevojat e tyre në banesa.

Referenca

- INSTAT (2018) Tregu-i-punes- <http://www.instat.gov.al/media/5575/tregu-i-punes-2018-ang-alb.pdf>
- INSTAT (2018) Burrat dhe gratë në Shqipëri 2018, http://www.instat.gov.al/media/4227/instat_rep_full.pdf
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2019) Kthim përgjigje mbi pretendimin për diskriminim për shkak të "etnisë" dhe "të gjendjes ekonomike"
- World Bank (2018): Western Balkans, Directions for the Energy Sector Final Report <http://documents.worldbank.org/curated/en/201391544823541838/pdf/Western-Balkans-Energy-Directions-Paper.pdf>
- ERE (2017): Rregullore mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë http://www.ikub.al/LIGJE_CATEGORY/18/03/30/MBI-FILLIMIN-E-PROCEDURE-S-PeR-MIRATIMIN-E-RREGULLORES-MBI-KUSHTET-SPECIFIKE-PeR--0193.aspx?cookiesEnabled=false
- World Bank (2017) Biomass-Based Heating in the Western Balkans <http://documents.worldbank.org/curated/en/135831542022333083/pdf/Biomass-Based-Heating-in-the-Western-Balkans-A-Roadmap-for-Sustainable-Development.pdf>
- INSTAT (2015) Roma and Egyptians in Albania: a socio-demographic and economic profile based on the 2011 census <https://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Census%202011%20Profile%20of%20Roma%20and%20Egyptians%20final.pdf>
- INSTAT (2020): Gender Equality Index for the Republic of Albania 2020 http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf
- INSTAT (2018) Anketa Buxheti i Familjes
- IDM (2014): Plani Ndërvendor për Zhvillimin e Komuniteteve rom dhe egjiptiane <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/Plani-Vlore-Novosele-final-25qershor-3.pdf>
- Milieukontakt Albania (2018): Dëmet e shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore <https://milieukontakt.org/demet-e-shkaktuara-nga-fatkeqesite-natyrore-ne-shqiperi/>
- CRCD, (2017): Performanca energjitike në ndërtesa përmes konceptit të varferisë energjitike
- INSTAT (2019): Popullsia e Shqipërisë http://www.instat.gov.al/media/5153/popullsia-1-janar-2019_final.pdf
- Bashkia Vlorë (2017): Plani i Përgjithshëm Vendor Vlore <http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3459&token=6e7a4819566178a46b8b1aa579e24e6fd8c417af>
- USAID (2014): Monitorimi i shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor në shqipëri <https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/KZLN-FinalReport%20-%20AL%20-%20DraftOK.pdf>
- ERE (2018): Raporti Vjetor ERE https://www.ere.gov.al/doc/Raporti_vjetor_ERE_2018_perfundimtar.pdf

Sitografi

www.reporter.al/harresa-e-qeverise-le-mijera-familje-ne-erresire/

Shtojca

1.1 Takime me aktorët vendorë








1.2 Gender equalite index Albania 2019


The index score in the domain of health is 81.8 and it is lower than EU-28 average for 6.3 points. Observed by subdomains it is noticeable that situation is better in the domains of status and access, but less favorable in the sub-domain of behavior. There is gender difference in selfperceived health. Persons who assess their health as good or very good are less represented among women than men (78.9 percent vs. 83.9 percent). Women are exposed less to some of the key health risk factors, such as smoking or harmful drinking. Differences in unmet needs for medical examination are relatively small, as among women 80.1 reported that they did not have unmet need, while among men there were 81.9 such persons.



HEALTH			81.8
	Status		91.6
		Self-perceived health, good or very good (%) W	78.9
		Self-perceived health, good or very good (%) M	93.9
		Life expectancy at birth (years) W	80.5
		Life expectancy at birth (years) M	77.4
		Healthy life years at birth (years) W	51.9
		Healthy life years at birth (years) M	54.6
	Behaviour		67.0
		People who don't smoke and are not involved in harmful drinking (%) W	95.0
		People who don't smoke and are not involved in harmful drinking (%) M	60.0
		People doing physical activities and/or consuming fruits and vegetables (%) W	57.9
		People doing physical activities and/or consuming fruits and vegetables (%) M	27.4
	Access		89.1
		Population without unmet needs for medical examination (%) W	80.1
		Population without unmet needs for medical examination (%) M	81.9
		Population without unmet needs for dental examination (%) W	79.0
		Population without unmet needs for dental examination (%) M	80.0

The Gender Equality Index in the domain of time


for Albania is 48.1. When viewed by sub-domains, it is observed that a slightly higher index value is recorded in the sub-domain of care activities than in the sub-domain of social activities (figure 11). There is remarkable difference between women and men in share of persons reporting that they care for their children or grandchildren, older people or people with disabilities every day (51.1 percent of women and 24.6 percent of men). The difference is even more prominent when everyday cooking and housework are in concern, since this kind of activity performs 87.8 percent of women and only 16.1 percent of men. On the other hand, women spend less time in sporting, cultural or other leisure activities outside of their home daily or several times per week – 31.4 percent of women and 43.9 percent of men. Among women 5.4 percent is involved in voluntary or charitable activities at least once a month, while among men there are 3.4 percent of such persons.



The index score for the domain of money is 59.6 points and it is lower than EU-28 average for 20.8 points. The value for index in subdomain of economic situation is much higher than in subdomain of financial resources.

The mean monthly earnings in 2018 for women amounted 1023 in Purchasing Power Standard (PPS) while for men were 1180 PPS. Mean equivalized net income was also lower for women than for men (4322 PPS vs. 4405 PPS). The differences in risks of poverty were not prominent. **In 2017, among women there were 78.1 percent of persons that were not at risk of poverty, while among men there was somewhat lower share of such persons - 77.5 percent.**

Figure 8: Gender equality index in the domain of money, Republic of Albania 2017, EU-28 2017, North Macedonia and Serbia³⁵



MONEY			59.6
	Financial resources		44.6
		Mean monthly earnings (PPS) Women	1023
		Mean monthly earnings (PPS) Men	1180
		Mean equivalized net income (PPS) W	4322
		Mean equivalized net income (PPS) M	4405
	Economic situation		79.6
		Not-at-risk-of-poverty (%) W	78.1
		Not-at-risk-of-poverty (%) M	77.5
		Income distribution S20/S80 (%) W	13.4
		Income distribution S20/S80 (%) M	13.5

The Index for domain of work in Albania is 67.6 and is lower than the average for EU-28 by 4.4 points. Full time equivalent employment rate was 40.2 percent for women and 54.6 percent for men.

DOMAINS	SUB-DOMAINS	INDICATORS	SCORES
TOTAL			60.4
WORK			67.6
	Participation		78.3
		Full-time equivalent employment rate (%) W	40.2
		Full-time equivalent employment rate (%) M	54.6
		Duration of working life (years) W	31.2
		Duration of working life (years) M	40.5
	Segregation and quality of work		58.4
		Employed people in education, human health and social work activities (%) W	13.8
		Employed people in education, human health and social work activities (%) M	3.9
		Ability to take one hour or two off during working hours to take care of personal or family matters (%) W	23.6
		Ability to take one hour or two off during working hours to take care of personal or family matters (%) M	27.1
		Career Prospects Index (points, 0-100) W	53.6
		Career Prospects Index (points, 0-100) M	56.0

1.3 Të dhëna nga Censusi 2011, Instat për qarkun Vlorë

2.4.6 Njësitë Ekonomike Familjare sipas bashkisë/komunës dhe llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje
2.4.6 Private households by municipality/commune and main type of energy used for heating

Bashkia/ Komuna Municipality/ Commune	Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje Main type of energy used for heating					
	Gjithsej Total	Dru Wood	Energji elektrike nga rrjeti Electricity from the grid	Gaz Gas	Lloj tjetër energjie (panel diellor, qymyr, nafte, etj) Other type of energy (solar panel, coal, oil, other)	Pa ngrohje No heating
Gjithsej Total	50 961	18 277	11 344	12 775	276	8 289
ALIBO	1 262	637	317	117	11	180
ARMEN	777	602	39	96	2	38
BRATAJ	752	711	12	9	2	18
DELVINË	1 694	883	477	150	3	181
DHIVËR	620	600	11	2	0	7
FINIQ	376	288	40	28	4	16
HIMARË	1 052	799	133	40	4	76
KONISPOL	593	418	47	80	1	47
KOTE	911	684	84	80	3	60
KSAMIL	823	228	220	112	9	254
LIVADHJA	447	396	22	1	4	24
LUKOVË	1 006	600	132	72	0	202
MARKKT	551	498	33	6	1	13
MESOPOTAM	874	797	48	9	6	13
NOVOSELË	2 374	1 410	73	456	10	425
ORIKUM	1 582	1 016	137	312	2	113
QENDËR	2 134	1 458	171	281	17	207
SARANDË	5 129	461	2 523	634	40	1 471
SELENICË	683	247	142	149	6	139
SEVASTER	412	373	29	5	0	5
SHUSHICË	1 108	556	184	315	8	45
VERGO	577	479	16	11	0	71
VLLAHINË	798	630	77	60	3	28
VLORE	22 755	2 428	6 250	9 614	118	4 345
VRANISHT	616	613	0	0	1	2
XARRË	1 055	465	126	130	21	307

1.4.9 Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të ngrohjes dhe zonës urbane dhe rurale 1.4.9 Private households by main type of heating and urban and rural area

Lloji kryesor i ngrohjes Main type of heating	Zona urbane dhe rurale Urban and rural area		
	Gjithsej Total	Urbane Urban	Rurale Rural
Gjithsej Total	50 961	33 520	17 441
Ngrohje qendrore në ndërtesë Common heating in the building	665	489	176
Ngrohje qendrore individuale në banesë Separate central heating in the dwelling	1 798	1 611	187
Stufë Stove	14 287	8 339	5 948
Oxhak Fireplace	9 678	2 881	6 797
Ngrohës elektrik Electric heater	7 464	6 195	1 269
Kondicioner Air conditioner	3 410	3 102	308
Lloj tjetër ngrohje Other type of heating	5 370	4 526	844
Pa ngrohje No heating	8 289	6 377	1 912

2.5.6 Banesat e banuara sipas bashkisë/komunës dhe llojit të ngrohjes 2.5.6 Inhabited dwellings by municipality/commune and type of heating

Bashkia/ Komuna Municipality/ Commune	Lloji i ngrohjes Type of heating								Pa ngrohje No heating
	Gjithsej Total	Ngrohje qendrore në ndërtesë Common heating in the building	Ngrohje qen- drore individ- uale në banesë Separate central heating in the dwelling	Stufë Stove	Oxhak Fireplace	Ngrohës elektrik Electric heater	Kondicioner Air condi- tioner	Lloj tjetër ngrohje Other type of heating	
Gjithsej Total	50 556	661	1 772	14 169	9 637	7 408	3 394	5 327	8 188
ALIBO	1 262	9	36	128	350	233	78	48	180
ARMEN	777	5	53	384	216	31	5	45	38
BRATAJ	741	12	4	212	477	9	3	6	18
DELVINË	1 689	3	25	586	352	428	44	72	179
DHIVËR	619	2	0	31	568	9	1	1	7
FINIQ	376	3	1	121	192	34	5	4	16
HIMARË	1 052	9	3	254	572	85	45	8	76
KONISPOL	578	5	1	189	289	29	14	4	47
KOTE	909	7	3	478	230	73	6	52	60
KSAMIL	802	11	7	215	53	123	89	54	250
LIVADHUA	447	0	4	58	339	18	3	1	24
LLUKOVË	994	4	5	216	396	96	30	48	199
MARKAT	550	10	0	42	448	29	4	4	13
MESOPOTAM	874	8	1	106	689	38	8	11	13
NOVOSELË	2 359	8	19	995	819	50	19	228	421
ORIKUM	1 581	32	9	477	675	68	67	138	115
QENDER	2 123	51	24	1 332	264	148	18	81	205
SARANDE	5 095	29	113	484	276	1 645	788	298	1 462
SELENICE	682	50	5	239	73	131	6	39	139
SEVASTER	403	0	0	292	78	27	1	0	5
SHUSHICË	1 105	36	20	476	248	169	9	103	44
VERGO	576	1	1	82	402	12	2	6	70
VLLAHINË	791	1	3	430	254	64	1	11	27
VLORE	22 504	359	1 430	6 029	605	3 760	2 124	3 926	4 271
VRIANESHT	616	1	0	79	529	0	0	5	2
XARRË	1 051	5	5	234	243	99	24	134	307